

BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 11 janar 2013

**Evenimenti i mbylljes së projektit të financuar
nga EIDHR:
“Arritja e barazisë gjinore në bashkësitë
rurale”**

(Qendra Informative e BE-së)

Fjalim nga
Shkëlqesia e Tij, z. Aivo ORAV
Shef i Delegacionit të BE-së

E nderuara zj. Grozdanova, të nderuar Kryetarë të Komunave, Zonja dhe zotërinj,

Kam nderin që sot jemi nikoqirë të evenimentit që shënon mbylljen e suksesshme të këtij projekti të financuar nga BE-ja, i cili ka për qëllim të përmirësojë barazinë gjinore në bashkësitë rurale.

Arritja e barazisë gjinore është një nga vlerat themelore të Bashkimit Evropian dhe si e tillë ndodhet në qendër të *Acquis* së BE-së. Kjo daton nga viti 1957 kur oarimi i pagesës së barabartë për punën e barabartë u bë pjesë e Traktatit të Romës.

Për më tepër, në Traktatin e Lisbonës, Bashkimi Evropian definon veten si ***"një shoqëri, në të cilën do të mbizotërojnë pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia midis femrave dhe meshkujve"***.

Gjatë dekadave të fundit, BE-ja ka arritur progres të dukshëm në barazinë gjinore mes femrave dhe meshkujve. Kjo është kryesisht në sajë të legjislacionit për trajtim të barabartë, integrim gjinor dhe masa të veçanta për përparimin e femrave.

Strategjia e BE-së për barazinë e femrave dhe meshkujve prezanton programin e punës së Komisionit Evropian për barazi gjinore për periudhën 2010-2015. Kjo është një kornizë gjithëpërfshirëse e cila angazhon Komisionin për të promovuar barazinë gjinore dhe fuqizimin e femrave në të gjitha politikat e veta.

Edhe më shumë, Strategjia thekson kontributin e barazisë gjinore në zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e qëndrueshëm, dhe mbështet zbatimin e shtrirjes së barazisë gjinore në "Strategjinë Evropa 2020".

Në lidhje me këtë proces në vend, ne përgëzojmë **Ligjin mbi mundësitë e barabarta për femrat dhe meshkujt**, i cili u miratua vitin e kaluar. Megjithatë, Raporti i Progresit i vitit të kaluar thekson se (citoj): "...**të drejtat e femrave dhe barazia gjinore**, zakonet diskriminuese, traditat dhe stereotipet janë të përhapura shumë dhe dëmtojnë të drejtat themelore të femrave, sidomos ato të femrave në zonat rurale. Pjesëmarrja aktive e femrave në jetën politike mbetet e ulët, veçanërisht në nivel lokal... Institucionet nuk ushtrojnë si duhet rolin e tyre në sigurimin e integritetit më të mirë të perspektivës gjinore në fusha të tjera të politikës."

Shumë mbetet për t'u bërë, për të hequr pengesat që ndalojnë pjesëmarrjen e plotë të femrave në shoqëri. Prandaj, janë të nevojshme shumë më tepër veprime që nxisin barazinë gjinore dhe fuqizimin e femrave.

Ky projekt, i financuar në kuadër të Instrumentit Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut, është një shembull i shkëlqyeshëm i veprimit të suksesshëm, i cili përmirëson barazinë gjinore në bashkësitë rurale përmes institucionalizimit të qasjes së integritetit gjinor në bërjen e politikave.

Femrat në bashkësitë rurale janë agjentët kryesorë të ndryshimit dhe janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e zonave rurale. Është me rëndësi thelbësore që kontributet e tyre të autorizohen dhe të njihen, kurse roli i tyre të përfshihet në të gjitha proceset e vendimmarrjes, në të gjitha nivelet e qeverisë.

Do të doja të uroj përpjekjet e Kryetarëve të Komunave Bogovinjë, Bërvenicë, Zhelinë dhe Vrapçishtë, si dhe Komisionet Komunale për Barazi Gjinore, për krijimin dhe emiratimin e Planeve Lokale të Veprimit për Barazinë Gjinore. Jam i bindur që ata do të kontribuojnë në synimin tonë të përbashkët: një shoqëri më e "barabartë gjinore".

Dua të falenderoj të gjithë të involvuarit në projekt për punën e tyre të shkëlqyer, sidomos organizatën e implemtimit të projektit – Shoqata për Zhvillimin Rural Lokal nga Tetova, si dhe partnerët e vet!

Falemnderit.